



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:268403

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05672852

KE.nr. 101/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike të paditësit AXA Versicherungen AG, me seli në Koln, Gjermani, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve “ICS” Assistance L.L.C., me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” Sh.A., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Kompania e Avokatëve “Arbresh”, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimi i borxhit nga baza e regresit, vlera e kontestit EUR 4,148.20, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 24.04.2024, në prani të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të të paditurës, me datë 13.05.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit AXA Versicherungen AG, me seli në Koln, Gjermani, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria” Sh.A., që në emër të regresit nga baza e sigurimit auto kasko, nga rasti i siguruar i datës 10.03.2018, t’ia paguaj paditësit shumën prej EUR 4,148.20, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 03.06.2019 e deri në pagesën definitive.
- II. DETYROHET paditësi AXA Versicherungen AG që të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” Sh.A., t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej EUR 1,209.00 (njëmijë e dyqind e nëntë Euro), në afat prej shtatë (7) ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Paditësi AXA Versicherungen AG me seli në Koln, Gjermani, përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 18.11.2019, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike ka paraqitur padi ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” Sh.A., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t’ia paguaj shumën prej EUR 4,148.00 në emër të regresit nga baza e sigurimit auto kasko për rastin e siguruar të datës 10.03.2018.

E paditura, me datë 09.06.2020 ka paraqitur përgjigje në padi me anë të së cilës e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si nga bazuar ashtu edhe për nga lartësia e saj.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktgjykimin I.EK.nr. 689/2019, të datës 06.09.2021, e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa ka detyruar të paditurën që nga baza e regresit nga sigurimi kasko, paditësit t’ia paguaj shumën prej EUR 4,148.20, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke llogaritur nga data 18.11.2019 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej EUR 1,535.70.

Ndaj këtij aktgjykimi e paditura ka paraqitur ankesë, ndërsa Gjykata e Apelit, me Aktvendimin Ae.nr. 253/2021, të datës 13.12.2021, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurës, Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr. 689/2019, të datës 06.09.2021 e ka anuluar dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është transferuar pranë Dhomave të shkallës së parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, sipas kompetencës lëndore të kësaj gjykate.

Në rivendosje, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën përgatitore dhe atë të shqyrtimit kryesor të datës 24.04.2024, në të cilën kanë prezantuar përfaqësuesit e autorizuar të palëve ndërgjyqëse.

Në seancat e mbajtura dhe fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka qëndruar pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ndërsa ka kundërshtuar ekspertizën e komunikacionit të punuar nga grupi i ekspertëve si të mangët dhe të paqartë. Me tej, ka shtuar se përkundër që ekspertiza e grupit të ekspertëve është e paqartë, nëse i referohemi konkluzionit dhe gjendjes faktike të konstatuar nga vet ekspertët, është konfirmuar se i siguruari i të paditurës ka ndërmarr veprimin e kthimit djathtas duke mos u rreshtuar djathtas, duke lëvizura fillimisht

në anën e majtë, me c' rast ka ndikuar tek i siguruari i paditëses të mos vogëloj shpejtësinë dhe të tentoj tejkalimin nga ana e djathtë, dhe se tejkalimi nga ana e djathtë e të siguruarit të paditësit ishte e lejuar konform nenit 70, pika 2.1 të Ligjit mbi trafikun rrugor. Andaj, ka theksuar se aksidenti është shkaktuar me fajin e të siguruarit të të paditurës, respektivisht i njëjti ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit dhe rrjedhimisht konform dispozitave ligjore nga neni 281 dhe 960 të LMD-së, ekziston përgjegjësia e të paditurës për shpërblimin e dëmit paditësit. Andaj, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadia e paditësit të aprovet në tërësi si e bazuar, ashtu që në emër të regresit nga baza e sigurimit auto kasko nga rasti i siguruar i datës 10.03.2018, paditësit t'ia paguaj shumën prej EUR 1,148.20, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 03.06.2019 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej EUR 2,076.50.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, përgjatë seancave gjyqësore si dhe në fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim e ka kontestuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke shtuar se pala paditëse nuk ka arritur të vërtetoj bazën juridike të kërkesëpadisë, ndërsa mbi bazën e ekspertizës së komunikacionit të punuar nga grupi i ekspertëve, është konstatuar se i siguruari i të paditurës nuk i ka kontribuar aksidentit si rezultat i së cilit kërkohet kompensimi i dëmit. Ndërsa, shpenzimet e procedurës i ka kërkuar duke i specifikuar, dhe atë për përpilimin e përgjigjes në padi, vlerën prej EUR 104.00, për përfaqësime në gjithsej tre seanca gjyqësore vlerën prej EUR 405.00 apo 135.00 për secilën seancë, në emër të ekspertizës së komunikacionit dhe makinerisë shumën prej EUR 250.00, si dhe në emër të ekspertizës së komunikacionit të punuar nga grupi i ekspertëve, shumën prej EUR 450.00, apo shumë e përgjithshme në emër të shpenzimeve procedurale prej EUR 1,209.00.

Gjykata, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor bëri administrimin e provave si në vijim: Polisën e sigurimit kasko me numër 70330790222; Vërtetimin për pagesën e dëmit; Librezën e qarkullimit të automjetit Mercedes Benz me targa ...; Ekspertizën për konstatimin e dëmit dhe shpenzimet e riparimit nr. 1798/637, e datës 25.04.2018 së bashku me foto dokumentacionin e automjetit; Kërkesën e paditësit për rimbushim tek e paditura e datës 03.06.2019 së bashku me komunikimet elektronike të palëve të datave 15.08.2019, 19.07.2019 dhe 03.06.2019; Ekspertizën e makinerisë dhe komunikacionit të punuar nga eksperti B.A.; Ekspertizën e komunikacionit e punuar nga skeptri S.B. e datës 29.12.2020; ekspertizën e brendshme e punuar nga eksperti S.B. e datës 12.07.2019,

si dhe; Ekspertizën e komunikacionit e punuar nga grupi i ekspertëve S.Sh., V.B. dhe M.H. e datës 10.12.2022.

Deklarimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se:

Në rastin konkret, për gjykatën dhe mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese fakti se me datë 10.03.2018 ka ndodhur aksidenti rrugor në fshatin Bujan në mes të automjetit Mercedes Benz i pajisur me polisë të sigurimit kasko nga pala paditëse dhe automjetit Ford Eskort i siguruar tek e paditura, fakti ky i cili vërtetohet edhe përmes raportit të aksidentit 2018 AR 0570.

Paoashtu, nuk ishte kontestues fakti se automjeti Mercedes Benz me targa të regjistrimit ..., ka qenë i siguruar tek pala paditëse mbi bazën e sigurimit auto kasko dhe se në momentin e asindetit ka poseduar këtë lloj të sigurimit, fakt ky që vërtetohet edhe nga polisa e sigurimit auto kasko nr. 70330790222.

Nga vërtetimi për pagesë, rezulton se paditësja i ka paguar të siguarit të saj dëmin e shkaktuar në automjetin e tij Mercedes Benz si rezultat i aksidentit rrugor, në lartësi prej EUR 12,445.00.

Nga ekspertiza për konstatimin dëmit dhe shpenzimeve të riparime e datës 25.04.2018, nr. 1798/637 si dhe foto dokumentacionit si pjesë përbërëse e kësaj ekspertize, janë konstatuar shpenzimet e riparimit të automjetit në lartësi prej EUR 19,768.77.

Nga kërkesa e paditësit dhe komunikimet elektronike mes palëve ndërgjyqëse rezulton se paditësi ka paraqitur kërkesë pranë të paditurës për pagesën e borxhit në emër të regresit, ndërsa e paditura ka refuzuar kërkesën dhe ankesën e paditësit të paraqitur për kompensimin e borxhit në emër të regresit.

Në ekspertizën e komunikacionit e datës 29.12.2020 e punuar nga eksperti S.B., është konstatuar se shkaktari kryesor i aksidentit ka qenë drejtuesi i automjetit të siguar tek paditësi, i cili duke lëvizur me shpejtësi të madhe në vendbanim nuk e ka mbajtur distancën e sigurisë pas automjeteve në lëvizje ka goditur automjetin tjetër ngasësi i së cilit ka qenë i siguruar tek e paditura, ndërsa kontribut sekondar ka dhënë edhe ky i fundit i cili gjatë kthimit djathtas nuk është rreshtuar në shiritin e skajshëm të trafikut përgjatë skajit të djathtë të sipërfaqes së rrugës.

Nga ekspertiza e datës 03.04.2021 e punuar nga eksperti i komunikacionit B.A., është konstatuar se drejtuesi i automjetit i siguruar tek paditësi duke mos pasur kujdes të shtuar në pjesën ku rruga kalon përgjatë vendbanimit dhe duke mos përshtatur shpejtësinë e automjetit të tij me kushtet dhe rrethanat e rrugës ka shkaktuar asindetin e komunikacionit, ndërsa në këtë aksident ka kontribuar edhe drejtuesi i automjetit të siguruar tek e paditura i cili përgjatë manovrës për kthim djathtas ka krijuar konfuzion tek drejtuesi i automjetit të siguruar tek e paditës.

Ndërsa, nga ekspertiza e makinerisë e datës 02.04.2021 poashtu e punuar nga eksperti B.A., është konstatuar fakti se automjeti i markës Mercedes Benz me targa ..., si rezultat i aksidentit ka pësuar dëm total në shumë prej EUR 12,444.00.

Gjykata, me propozimin e palës së paditur dhe sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, në rivendosje ka bërë marrjen e provës përmes ekspertizës së komunikacionit nga grupi i ekspertëve i përbërë prej S.Sh., V.B. dhe M.H.. Grupi i ekspertëve, në ekspertizën e punuar me datë 10.12.2022, ka konstatuar se deri te aksidenti i komunikacionit rrugor ka ardhur nga lëshimet e bëra na ana e drejtuesit të automjetit të siguruar tek e paditësi, i cili ka lëvizur me automjet me shpejtësi më të madhe se shpejtësia e lejuar e lëvizjes në atë pjesë të rrugës, si e tillë shpejtësi e papërshtatshme për kushtet dhe rrethanat e krijuara në rrugë, ndërsa veprimet e drejtuesit të automjetit tjetër të siguruar tek e paditura i cili kthimin djathtas e ka bërë duke lëvizur fillimisht në anën e majtë, nuk ka ndikuar në shkaktimin e aksidentit.

Ndërsa, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 24.04.2024 përfaqësuesi i grupit të ekspertëve ka qëndruar në tërësi pranë gjetjeve në ekspertizën e komunikacionit të punuar me datë 10.12.2022. Tutje, ka shtuar se lidhur me veprimet e automjetit 'B' të siguruar tek e paditura nuk është arritur të konstatohet se çfarë harku ka marr dhe sa ka lëvizur në anën e majtë të rrugës, mirëpo që bazuar në raportin e policisë kanë ardhur në përfundim se kthimi i tij nuk ka qenë në rregull, mirëpo që edhe përkundër kësaj lëshimi ka qenë i automjetit 'A' i cili ka lëvizur me shpejtësi të papërshtatshme dhe më të madhe se shpejtësia e lejuar për atë pjesë të rrugës dhe se sikur i njëjti të kishte lëvizur me shpejtësinë e kufizuar aksidenti i trafikut nuk do të kishte ndodhur, andaj edhe grupi i ekspertëve ka ardhur në përfundim se shkaktar i aksidentit ka qenë drejtuesi i automjetit 'A' i siguruar tek e paditësi.

Pas administrimit me provat e propozuara dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqëse, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e pabazuar, për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 281 i Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve (tutje referuar si “LMD”) “Kur detyrimin e përmbush personi i cili ka ndonjë interes juridik në këtë çështje, atëherë i kalojnë këtij, në bazë të vet ligjit, në çastin e përmbushjes, kërkesat e kreditorit me të gjitha të drejtat aksesore”. Ndërsa, sipas nenit 960.1 të të njejtit ligji, është përcaktuar se “Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin.” Nisur nga kjo dispozitë, rrjedhë se me pagimin e shpërblimit nga sigurimi, siguruesi fiton të drejtën ndaj personave të tretë për të kërkuar shpërblimin e dëmit, me kusht që të vërtetohet ekzistimi i përgjegjësisë apo kontributit të personit të tretë në shkaktimin e dëmit.

Në këtë drejtim, bazuar në provat e administruara, deklaratimet e palëve ndërgjyqëse dhe dispozitat ligjore të cekura si më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsytet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit paditësit mbi bazën e regresit, pasi që i siguruari i të paditurës i përfshirë në aksidentin e datës 10.03.2018 nuk është përgjegjës dhe nuk ka dhënë kontribut në shkaktimin e këtij aksidenti të komunikacionit. Deri tek ky konstatim, gjykata u bazua në shkresat e lëndës, e posaçërisht në ekspertizën e komunikacionit rrugor të punuar nga grupi i ekspertëve i përbërë nga S.Sh., V.B. dhe M.H., dhe deklaratimit të përfaqësuesit të grupit të ekspertëve në seancën e shqyrtimit kryesor, nga ku është arritur në konkludim se deri tek aksidenti i komunikacionit rrugor ka ardhur me lëshimet e bëra nga ana e automjetit ‘A’, përkatësisht automjetit të të siguruarit të paditësit, i cili ka lëvizura me shpejtësi më të madhe se shpejtësia e lejuar e lëvizjes në atë pjesë të rrugës, shpejtësi kjo e papërshtatshme për kushtet dhe rrethana e krijuara në atë rrugë, me c ‘rast me pjesën e përparme të anës së majtë ka goditur automjetin ‘B’ i siguruar tek e paditura, në pjesën e pasme anësore të djathë, ndërsa është konstatuar se veprimet e drejtuesit të automjetit ‘B’ të siguruar tek e paditura nuk kanë qenë me ndikim në shkaktimin e aksidentit të trafikut rrugor.

Gjykata, ekspertizës së komunikacionit të punuar nga grupi i ekspertëve ia ka falur në tërësi besim për shkak se e njëjta është punuar në mënyrë profesionale, brenda kufijve dhe vëllimeve të përcaktuara nga gjykata, dhe se e njëjta mbështetjet edhe në provat e tjera materiale të cilat gjenden në shkresa të lëndës.

Andaj, duke qenë se i siguruari i të paditurës nuk ka qenë shkaktar dhe nuk i ka dhënë kontribut shkaktimit të aksidentit të trafikut rrugor, atëherë nuk janë plotësuar kushtet nga neni 960 i LMD-së, përkatësisht nuk është vërtetuar përgjegjësia e të siguarit të të paditurës në raport me aksidentin e shkaktuar, dhe rrjedhimisht gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Gjykata ka vlerësuar ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti S.B., mirëpo të njejtës nuk ia fali besimin pasi që, nga kjo ekspertizë nuk ishte arritur të sqarohej plotësisht kontributi i pjesëmarrësve në aksidentin e shkaktuar dhe se e njëjta ishte në kundërshtim me provat materiale që gjenden në shkresa të lëndës, e për më tepër kontradiktore, nga fakti se në ekspertizë është konstatuar se, sikurse drejtuesi i automjetit 'A' i siguar tek paditësi të kishte drejtuar automjetin sipas rregullave dhe shenjave si dhe duke mbajtur edhe distancën e duhur nuk do të kishte ardhur deri tek aksidenti, ndërsa në anën tjetër është konstatuar se automjeti 'B' i siguar tek e paditura i ka dhënë kontribut aksidentit.

Poashtu, gjykata nuk ia fali besimin ekspertizës së komunikacionit të punuar nga eksperti B.A., ngase e njëjta ekspertizë ishte në kundërshtim me provat materiale të administruara dhe gjendjen faktike, e poashtu në të njejtën ekspertizë, përkundër që ishte konstatuar se shkaktari i aksidentit ka qenë i siguruari tek paditësi dhe sikurse i njëjti ta kishte përshtatur shpejtësinë do të kishte mundësi teknike të evitonte aksidentin, eksperti ka ardhur në përfundim se kontribut aksidentit i ka dhënë edhe drejtuesi i automjetit të siguar tek e paditura.

Ndërsa, gjykata ka vlerësuar edhe ekspertizën e makinerisë të punuar nga eksperti B.A., mirëpo duke qenë se në këtë çështje kontestimore paditësi nuk ka arritur që të vërtetoj bazën e kërkesëpadiës përkatësisht nuk u vërtetuar përgjegjësia e drejtuesit të automjetit të siguar tek e paditura, e njëjta nuk kishte ndonjë ndikim në vendosje ndryshe nga ana e gjykatës.

Në anën tjetër, duke qenë se gjykata ia ka falur në tërësi besimin ekspertizës së grupit të ekspertëve, përmes aktvendimit procedural të marr në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 24.04.2024, ka refuzuar propozimin e paditësit për ballafaqimin e anëtarëve të grupit të ekspertëve me ekspertët S.B. dhe B.A., pasi që ka vlerësuar se përmes ekspertizës së grupit të ekspertëve mjaftueshëm është vërtetuar gjendje faktike në këtë çështje juridike dhe se me ballafaqimin e ekspertëve nuk do të arrihej ndonjë rezultat tjetër.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat e tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesor, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike kontestimore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.2 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i paditësit, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga e paditura dhe atë shumën prej EUR 135.00 për çdo seancë të mbajtur konform rregullores mbi tarifatat e avokatëve, apo shumën e përgjithshme në emër të tri (3) seancave gjyqësore të mbajtura (3x135.00) në lartësi prej EUR 405.00, ndërsa në emër të ekspertizës së komunikacionit dhe makinerisë të punuar nga eksperti B.A., shumën prej EUR 250.00, si dhe në emër të pagesës për ekspertizën e punuar nga grupi i ekspertëve, shumën prej EUR 450.

Nga arsyet e cekura më lartë, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

#### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 101/23, datë 13.05.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.